



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 203/3 prot.

Tiranë, më 23.05.2022

VENDIM

Nr.75, datë 23.05.2022

**PËR
PEZULLIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 142, DATË 17.11.2021**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraparak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr.142, datë 17.11.2021, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procesit të vlerësimit periodik Janar - Qershor 2021, të nëpunëses *****, me detyrë “Inspektore”, në Drejtorinë e Inspektimit të Punës, në institucionin Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.”

KONSTATOVA SE:

Nëpunësja civile *****, nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 776 prot., datë 1.09.2021, ka ngritur disa pretendime për parregullsi të shumta ligjore, të lejuara gjatë realizimit të procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Janar - Qershor 2021.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti, duke kërkuar nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, të dërgojë të gjithë dokumentacionin që disponon në lidhje me këtë rast.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr.142, datë 17.11.2021, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procesit të vlerësimit periodik Janar - Qershor 2021, të nëpunëses *****, me detyrë

“Inspektore”, në Drejtorinë e Inspektimit të Punës, në institucionin Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.”

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr.142, datë 17.11.2021, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil për rastin në fjalë paraqitet si më poshtë vijon:

Komisioneri ka kërkuar nga Kryeinspektori i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, në cilësinë e *Zyrtarit Autorizues*, të vendosë anulimin e procesit dhe aktit të vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Janar – Qershor 2021, për nëpunësen civile ******, si një proces i kundërligjshëm dhe përsëritjen e e tij nga fillimi, në të gjitha hapat e tij.

Konstatohet se, me e-mailin e datës 4 prill 2022, njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ka informuar Komisionerin se çështja në fjalë është bërë objekt trajtimi në rrugë gjyqësore.

Vlerësoj se, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i ndryshuar, si dhe nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile, duhet të **pezullohet procesi i mbikëqyrjes në vazhdim**, për këtë rast deri sa Gjykata të shprehet me vendim të formës së prerë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Pezullimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr.142, datë 17.11.2021, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procesit të vlerësimit periodik Janar - Qershor 2021, të nëpunëses ******, me detyrë “Inspektore”, në Drejtorinë e Inspektimit të Punës, në institucionin Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.”*

2. Për këtë vendim të njoftohet, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha